



LICENCIMI I NJË SHOQËRIE TË RE NË TREGUN E SIGURIMEVE NË SHQIPËRI – SINJAL POZITIV QË SHPREH INTERESIN E INVESTITORËVE TË RINJ PËR KËTË TREG

Enkeleda Shehi, Kryetare e AMF-së

Vijon në faqen 2

VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-maj 2012

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-maj 2012 arritën shifrën 3,359,472 mijë lekë, përkundrajt 3,602,902 mijë lekë të realizuara në janar-maj 2011.

Vijon në faqen 3

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Opinion

H.Bakke, Iniciativat Strategjike, LLC, USA

Shqipëria - e dyta ndër 13 vende të rajonit për sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve realizuar përmes faqes zyrtare në Internet të AMF-së.

Vijon në faqen 5

ZHVILLIME TË TJERA

Inspektim i përbashkët i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Rrugore për policat e sigurimit të detyrueshëm të automjeteve.

Vetëm 0.65% e mjeteve të inspektuara nuk ishin të pajisura me polica sigurimi të detyrueshëm.

Vijon në faqen 8

Mbledhja e përbashkët e grupeve të punës së IOPS-it dhe OECD-së mbi Pensionet Private.

Vijon në faqen 9

Licencohet shoqëria "ANSIG" sh.a. për ushtrim veprimtarie në tregun e sigurimeve.

Vijon në faqen 11

Takime të Kryetares së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me Shoqatën e Sigurimeve të Austrisë dhe shoqëritë austriake që veprojnë në tregun e sigurimeve në Shqipëri.

Vijon në faqen 11

Përfaqësues të tregjeve të kapitaleve të Evropës Juglindore fillojnë punën për zbatimin e Platformës Rajonale të Integritimit. – Mbështetje nga Programi për Stabilitet Financiar, USAID.

Vijon në faqen 13

TË REJA NGA RAJONI

Kroaci: Primi shkruar bruto vazhdon të bjerë.

Vijon në faqen 13

Greqi: Produktet e lidhura me investimet mbajnë tregun.

Vijon në faqen 13

Azerbaxhan: Rritje spektakolare dhe një lider i ri.

Vijon në faqen 14

Mali Zi: Primet e shkruara bruto rriten me 14%.

Vijon në faqen 15

Rusi: 2013, viti kur do të zbatohen sistemi TI dhe Bonus-Malus.

Vijon në faqen 15

LICENCIMI I NJË SHOQËRISË TË RE NË TREGUN E SIGURIMEVE NË SHQIPËRI – SINJAL POZITIV QË SHPREH INTERESIN E INVESTITORËVE TË RINJ PËR KËTË TREG

Licencimi i shoqërisë së re të sigurimit, “ANSIG”, i shton tregut të sigurimeve në Shqipëri edhe një shoqëri të re, duke e çuar në 11 numrin e operatorëve në treg. Licencimet e fundit në këtë treg datojnë që në vitin 2004. Shoqëritë e sigurimit, që ushtrojnë aktualisht veprimtari sigurimi janë licencuar para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe rrjedhimisht licencimi i shoqërisë së re “ANSIG” sh.a., përfaqëson shoqërinë e parë të sigurimit të licencuar me kuadrin rregullator në fuqi.

Licencimi i shoqërisë “ANSIG” nga Bordi i AMF-së vjen pas një procesi të gjatë, gati një vjeçar shqyrtimi dhe diskutimi me shoqërinë aplikuese për përputhshmërinë me kërkesat ligjore. Në përputhje me Ligjin, në nëntor 2011, Bordi i AMF-së miratoi licencimin paraprak të shoqërisë “ANSIG”, që konsistonte në përmbushjen e kërkesave për konturimin e biznesit të sigurimit.

Faza e dytë dhe përfundimtare e licencimit ishte e lidhur me krijimin dhe regjistrimin e shoqërisë, kontraktimin e stafit drejtues, derdhjen e shumës së kapitalit themeltar dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për fillimin e aktivitetit. Futja e një operatori të ri në tregun e sigurimeve, sidomos në një moment të vështirë që po kalon ekonomia e vendit, është një sinjal tepër pozitiv. Ky sinjal duhet të interpretohet



*Enkeleda Shehi,
Kryetare e AMF-së*

në disa drejtime. Së pari konfirmon zhvillimin e vazhdueshëm të tregut dhe faktin që tregu i sigurimeve është tërheqës për investitorë të rinj. Kështu tregut të sigurimeve i injektohen menjëherë edhe 370 mln lekë kapitale, që do të thotë kapacitet shtesë për nënshkrimin e risqeve në tregun vendas. Efektet pozitive shtrihen dhe në aspektin e hapjes së vendeve të reja të punës, pasi shoqëria e re do ketë përfaqësi në qytetet kryesore të vendit. Të gjitha këto janë sinjale pozitive për këtë segment të tregut financiar, dinamika e zhvillimit të të cilit ka bërë që të jetë vazhdimisht në fokusin e investitorëve strategjikë.

Nisur nga specifika që ka biznesi i sigurimeve, pritet që futja e operatorit të ri do të rrisë më tepër presionin ndaj tregut për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorit. Konkurrenca cilësore është gjithnjë në interes të konsumatorit, por jo vetëm kaq; për AMF-në, një treg konkurrent me një numër të mjaftueshëm operatorësh, do të thotë më tepër hapësirë dhe fleksibilitet për ushtrimin e mekanizmave mbikëqyrëse dhe kjo

Licencimi i shoqërisë “ANSIG” nga Bordi i AMF-së vjen pas një procesi të gjatë, gati një vjeçar shqyrtimi dhe diskutimi me shoqërinë aplikuese për përputhshmërinë me kërkesat ligjore.

përkthehet direkt në favor të mbrojtjes së konsumatorit.

AMF në thelb të punës së saj ka gjithnjë mbrojtjen e konsumatorit. Realizimi i këtij objektivi duhet parë si një proces i vazhdueshëm i punës së AMF-së dhe dikton një sërë objektivash konkretë, që për vitin 2012 AMF i ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme. Konkretisht fokusi është

tek rritja e cilësisë dhe efektivitetit të procesit mbikëqyrës, përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor e rregullativ, forcimi i pavarësisë dhe transparencës së AMF-së, rregullimi efektiv i tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik, etj. Të gjitha këto objektiva zërthehen në një sërë projektesh dhe zhvillimesh që AMF ka në proces dhe që do komunikojë në vazhdimësi për ecurinë e tyre.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-maj 2012


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-maj 2012 arritën shifrën 3,359,472 mijë lekë, përkundrajt 3,602,902 mijë lekë të realizuara në janar-maj 2011 ose 6.76% më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 54.98% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 45.02% të tregut. Përsa i takon tregjeve, në veçanti, kemi një rënie në masën

12.13% të sigurimeve të Jetës dhe një rënie prej 5.88% të sigurimeve të Jo-Jetës. Nga të ardhurat gjithsej të tregut 88.63% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 11.25% nga veprimtaria e Jetës dhe 0.13% nga veprimtaria e risigurimit.

Në janar-maj 2012 u nënshkruan rreth 381,367 kontrata sigurimi, ose 25.65% më pak se në janar-maj 2011.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-maj 2012 arritën shifrën 3,359,472 mijë lekë


Struktura e tregut të sigurimeve, për janar-maj 2011



Volumi i primit të shkruar bruto, për janar-maj (2011-2012)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2011	2012
janar-maj		
A) Sigurim i Jetës	353,555	314,890
B) Sigurim i Jo-Jetës	2,585,341	2,374,626
<i>Nga këto:</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	1,273,443	1,172,198
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	1,311,899	1,202,428
C) Risigurimi	-	4,262
TOTAL	2,938,897	2,693,779

Volumi i primit të shkruar bruto, për janar-maj 2011 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar-maj 2012, arritën 1,144,241 mijë lekë, ose 24.07 % më shumë se janar-maj 2011.

Sigurimet e detyrueshme motorike

Në janar-maj 2012, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 1,512,312 mijë lekë të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar-maj 2012, arritën 1,144,241 mijë lekë, ose 24.07 % më shumë se janar-maj 2011.

Në janar-maj 2012, primet e shkruara bruto të Kartonit Jeshil ishin 270,943 mijë lekë, ose rreth 50.83% më pak se në janar-maj 2011. Kjo ulje e primit të shkruar bruto Karton Jeshil lidhet me liberalizimin tregut të sigurimit të detyrueshëm në gusht të vitit 2011.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar-maj 2012 arritën në 97,128 mijë lekë, apo 6.51% më shumë se në janar-maj 2011.

Sigurimet vullnetare

Për janar-maj 2012, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 1,847,160 mijë lekë, ose 9.38% më pak se të ardhurat e janar-maj 2011.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 1,465,103 mijë lekë, vendin

e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe dëme të tjera në pronë me 46.36% të pasuara nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit me 20.18% dhe nga sigurimi kasko me 15.61 %, peshë më të ulët patën sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile, sigurimet e garancisë.


Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar-maj 2012, arritën në 295,625 mijë lekë, 29.64% më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e klasës 1, sigurimi i aksidenteve me 54.69% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në janar-maj 2012 arritën në 377,795 mijë lekë, ose 12.13% më pak se në janar-maj 2011.


Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal Uniqa Group Austria, Sigma Vienna Insurance Group, Insig, Atlantik, Interalbanian, Albsig, Intersig Vienna Insurance Group dhe Eurosig. Sigal Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me 32.46 % të primeve.

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për janar-maj 2012 (Jo-Jeta)



Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për janar-maj 2012 (Jeta)



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life Uniqa

Group Austria, Insig dhe Sicred. Sigal-Life Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me 41.92 % të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-maj 2012 kapi vlerën 1,302,489 mijë lekë, ose 44.20 % më shumë se në janar-maj 2012. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 877,127 mijë lekë, apo 53.57 % të totalit.

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Shqipëria - e dyta ndër 13 vende të rajonit për sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve realizuar përmes faqes zyrtare në internet të AMF-së

Opinion

H.Bakke,

Iniciativat Strategjike, LLC, USA

Holly Bakke ishte trainerja që udhëhoqi takimin rajonal “Mbrojtja konsumatore në sigurime, praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare” që u zhvillua në Tiranë më 31-maj deri më 1 qershor. Gjithashtu ajo pati takime konsultative në vazhdim edhe me stafin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Tiranë për të diskutuar mbi forcimin e rolit të Autoritetit në mbrojtjen e konsumatorit. Të dy këto aktivitete u mbështetën nga USAID nëpërmjet Programit të Zhvillimit të Sektorit Financiar në Shqipëri FSVC dhe Programit Rajonal PFS.

Holly Bakke ka përfunduar studimet B.A. në Drew University, USA, 1973. Ajo është anëtare e Institutit për Menaxhimin e Gjykatës dhe ka marrë diplomën e nivelit më të lartë nga Seton Hall University-Shkolla e Ligjit në vitin 1982. Gjatë karrierës së saj, znj Bakke ka shërbyer si Zëvendës Komisionere në Departamentin e Sigurimeve në New Jersey dhe si anëtare e Bordit të Fondit për Pakënaqësitë e Kërkesave për Dëmshpërblim ndaj Vendimeve Gjyqësore. Ajo ka qenë edhe Drejtore Ekzekutive e Shoqatës së Garancisë së Sigurimit të Përgjegjësive ndaj Pronës në New Jersey, si pjesë e sistemit kombëtar, përgjegjëse për menaxhimin e dëmeve të papaguara. Në këtë cilësi, ajo gjithashtu mbikëqyr Fondin e Garancisë për Sigurimin Ndërkufitar dhe Shoqatën e Risigurimeve për Neglizhencën në Fushën e Mjekësisë. Gjatë punës saj si Komisionere për Bankat dhe Sigurimet në New Jersey u hartuan dhe miratuan reformat revolucionare të sigurimit motorik duke përfshirë sanksionet më të rrepta në të gjithë vendin për mashtrimin në sigurimin motorik; mbrojtjen konsumatore e njohur kombëtarisht; metodat te reja për zvogëlimin e numrit të shoferëve të pasiguruar, si dhe u ndërmorrën dhe hapat e mëtejshëm për të ulur presionin për tarifën për shoferët e mirë. Ajo gjithashtu paraqiti rregulla të reja në fushën e pasurive të patundshme, mbrojtjen e konsumatorit dhe praktikën e huadhënies.

Më poshtë është opinioni i znj. H.Bakke mbi mbrojtjen e konsumatorit shqiptar në sigurime.

USAID është mjaft i angazhuar dhe ndjek me vëmendje ecurinë e tregjeve të sigurimeve në vendet në zhvillim.

Ne shikojmë disa komponentë, shikojmë se si kompanitë janë të rregulluara financiarisht dhe ndjekim

Dua të theksoj përsëri, se Shqipëria renditet e 2-ta nga të gjitha vendet që ne anketuam në Evropën Juglindore dhe Euroazi për informacionin që jepet për konsumatorin në faqen e Internetit. Përveç kësaj, kemi parë interes të rritur në ofrimin e materialeve për konsumatorët, që do të thotë të ndihmohen konsumatorët e të kuptojnë produktet e sigurimit.

gjithashtu me vëmendje mbrojtjen që u bëhet konsumatorëve në këto tregje.

Kohët e fundit ne kemi ndërmarrë një anketim në 13 vende të Evropës Juglindore dhe kanë dalë rezultate interesante. Sipas studimit, Shqipëria renditet e dyta për sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve, e cila shihet në faqen zyrtare të Autoritetit. Ne mendojmë që kjo është veçanërisht e rëndësishme, ndërkohë që njerëzit familjarizohen me përdorimin e internetit dhe ai shtrihet në të gjithë vendin. Nga bisedimet me AMF-në ne kemi parë se po ndërmerret një program shumë i plotë për mbrojtjen e konsumatorit. Dua të theksoj përsëri, se Shqipëria renditet e 2-ta nga të gjitha vendet që ne anketuam në Evropën Juglindore dhe Euroazi për informacionin që jepet për konsumatorin në faqen e Internetit. Përveç kësaj, kemi parë interes të rritur në ofrimin e materialeve për konsumatorët, që do të thotë të ndihmohen konsumatorët e të kuptojnë produktet e sigurimit. Gjithashtu stafi i AMF-së ndihmon konsumatorët në ankesat e tyre. Nëse një individ ka shqetësim në lidhje me një kompani të veçantë dhe pretendime ndaj saj, ata e dinë se pranë AMF-së u sigurohet asistencë. Një nga gjërat për të cilat edhe AMF është e vetëdijshme është shtimi i numrit të qytetarëve që duhet ti përdorin këto mundësi dhe të deklarojnë ankesat e tyre pranë Autoritetit. Deri tani numri i ankesave ka qenë nën 100 dhe AMF pret të shohë që ky numër të rritet në mënyrë që qytetarët të ndërgjegjësohen që AMF e siguron këtë lloj shërbimi.

AMF ka bërë një punë të madhe për sa i përket mbrojtjes së konsumatorit dhe me rezultate të mira. Ka disa fusha të tjera ku AMF mund të prezantojë procedura të reja dhe praktika që do t'iu sigurojnë konsumatorëve mbrojtje edhe më të madhe. Unë do të doja të theksoj katër prej tyre:

- E para, ka të bëjë me përpjekjet për të arritur gjithnjë e më shumë tek konsumatorët. Deri tani kam përmendur broshurat që AMF ka apo linjën telefonike në shërbim të ankesave të publikut. Do të doja të bëhet më shumë për të shkuar përtej qyteteve të mëdha, për të arritur tek zonat rurale dhe për t'u treguar se AMF është për t'i ndihmuar ata.
- Së dyti, ne dëshirojmë të shohim që AMF të angazhohet më shumë me kompanitë, në drejtim të asaj që se cilat janë pritshmëritë e AMF-së ndaj kompanive kur këto të fundit përballen me ankesat. Ne jemi në diskutime rreth një protokolli që do t'u jepet kompanive, në qoftë se ka një ankesë duke ju thënë se ky është informacioni që ne presim që ju t'u siguron konsumatorëve, kjo është se si ne presim që ju ta trajtoni atë ankesë. Ky koordinim do të rezultojë në mbrojtjen më të mirë të konsumatorit.
- Së treti, unë mendoj se është e rëndësishme që konsumatori të dijë se mbrojtja që AMF ofron shkon më tej se vetëm dhënia e informacionit apo ndihma me ankesat. Kështu konsumatorët vlerësojnë faktin se AMF punon çdo ditë për të siguruar që kompanitë e sigurimit janë financiarisht të qëndrueshme, pra në gjendje për të përmbushur detyrimet e tyre ndaj konsumatorëve. Gjithashtu, është e rëndësishme që edhe ndërmjetësit, të cilët shesin policat e sigurimit, të jenë të aftë, të kenë njohuritë e duhura dhe të trajtojnë konsumatorët në mënyrë të drejtë dhe të ndershme. Pra, pavarësisht punës së madhe që është bërë deri tani me ndërmjetësit, me prospektin financiar të shoqërive dhe me mbrojtjen e konsumatorit, unë

mendoj se ka shumë pika të forta për të cilat AMF duhet të vazhdojë të punojë për t'i forcuar.

- Së fundi, është mënyra se si do të ndërtohet e gjithë kjo. Deri tani ne kemi diskutuar përgjithësisht situata individuale, ankesa individuale të konsumatorëve dhe statusin individual të një shoqërie. Një nga gjërat që ne do të donim të shihnim të realizohet në Shqipëri, (e cila është bërë jo vetëm në SHBA, por edhe në vendet e tjera) është që të zhvillohet një program për sjelljen e tregut. Shqipëria është përmendur për punën e mirë që ka bërë në analizën financiare të shoqërive dhe që në thelb thotë se është kjo është shoqëri është financiarisht e qëndrueshme për të përmbushur detyrimet e veta. Por kjo analizë financiare nuk e shpjegon se si shoqëria i trajton mbajtësit e policës së sigurimit. Pikërisht këtë analizon një program mbi sjelljen e tregut. Analiza e sjelljes së tregut i jep rregullatorit, AMF-së, mundësinë për të parë praktikën e biznesit të një shoqërie në tregun e saj. Kështu mund të shikohen reklamat dhe në se janë përdorur saktë ato, mënyrën se si shkruhen policat e sigurimit, a janë të ndershëm shoqëritë për sa i përket policave që ofrojnë, a janë refuzuar polica që nuk duhen të ishin refuzuar, a paguhen dëmet në kohë, etj. Kështu, që nga përmbledhja e këtyre faktorëve, ne do të themi se si operon në treg kjo shoqëri. Ne besojmë fuqishëm se këto dy informacione, si ai që i përket stabilitetit financiar të shoqërisë dhe ashtu edhe mënyra sesi ajo sillet në treg, janë faktorë kritikë për të qenë një rregullator sa më efektiv.

Një nga pikat që një rregullator duhet të

mbaj parasysh është se konsumatorët janë zotëruesit e policës së sigurimit. Kështu, që si kompania e sigurimit ashtu edhe autoritetet rregulluese kanë detyrime ndaj zotëruesit të policës së sigurimit, pra konsumatorit. Nga eksperiencat ndërkombëtare, kompanitë e mira njohin faktin që për të vazhduar të zgjerohen si biznese, të shtojnë fitimet e tyre dhe të shtojnë numrin e konsumatorëve, ata duhet ti marrin shumë seriozisht detyrimet ndaj konsumatorëve. Kështu, kompanitë e suksesshme dhe të respektuara shkojnë tek zotëruesi i sigurimit me informacione e saktë mbi produktet që po shesin. E përsëris, kompanitë e mira, ato që duan të tërheqin zotërues të rinj të policave, sigurohen që të paguajnë dëmet në kohë.

Një tjetër pjesë e rëndësishme është konkurrueshmëria në treg. Ajo çfarë e dallon një kompani të mirë nga një tjetër është mundësia dhënies së informacionit nëpërmjet faqes së tyre të internetit, apo fakti që klientët mund të shkojnë tek kompania e të thonë: kam një ankim, kujt duhet t'i drejtohem. Dhe kompania gjen menjëherë personin e duhur, i cili duhet të ketë jo vetëm njohjen e nevojshme, por edhe autoritetin për ta zgjidhur ankesën. Në kushte ideale, kur kompania bën një punë të mirë, ky ankim asnjëherë nuk arrin të shkojë deri tek Autoriteti rregullator. Kjo është ndoshta një periudhë tranzicioni si për kompanitë shqiptare edhe për rregullatorin që të zgjerojnë e zhvillojnë më tej aftësitë për mbrojtjen e konsumatorëve. Idealja do të ishte, që në një treg sigurimesh konkurrense, kompanitë të vlerësojnë dhe të sigurohen se zotëruesit e policës së sigurimit janë trajtuar me drejtësi, kjo është rruga e tyre drejt suksesit, kështu ato bëhen kompani më fitimprurëse dhe zgjerojnë pjesëmarrjen në treg. Kur kompanitë kuptojnë këtë, atëherë

AMF ka bërë një punë të madhe për sa i përket mbrojtjes së konsumatorit dhe me rezultate të mira.

Në mënyrë që një autoritet të sigurojë mbrojtje të përshtatshme për konsumatorin duhet që ai vetë të jetë i pavarur nga ana financiare dhe operative dhe kështu konsumatori të jetë në qendër të vëmendjes. Pavarësia financiare e ndihmon Autoritetin të ketë burimet e mjaftueshme që i nevojiten për të mbrojtur konsumatorin, të ketë stafin e duhur, të aftë e të mirëtrajnuar dhe të gjitha këto janë vendimtare.

ata bëhen zgjidhësit e problemit për konsumatorët e tyre dhe rregullatorët duhen vetëm kur një zotërues sigurimi nuk arrin të kënaqet nga kompania, por kjo bëhet gjithmonë dhe më e rrallë, sepse kompanitë i realizojnë detyrimet e tyre ndaj zotëruesit të policës së sigurimit.

Një nga çështjet me të cilat të gjithë jemi të shqetësuar është kur konsumatorët i drejtohen autoritetit rregullues apo shoqërisë së sigurimeve për të zgjidhur një ankesë, ata të gjithë duan që çështja të zgjidhet shpejt dhe me një përfundim të qartë.

Në shumë vende ku sistemi gjyqësor është tepër i ngarkuar, mund të marrë një kohë shumë të gjatë për të zgjidhur çështje të vogla të ankesave për sigurimet. Kështu këto vende kanë kërkuar mënyra të tjera për të zgjidhur problemet me sigurimet. Disa sisteme gjyqësore kanë siguruar një teknikë që quhet “Ndërmjetësim”. Kështu që kur një mosmarrëveshje sigurimi i paraqitet gjykatës, më parë i çohet një programi ndërmjetësimi. Ndërmjetësuesi është një person neutral, i cili takohet me të dy palët: si përfaqësuesit e shoqërive të sigurimit ashtu edhe klientin që është zotëruesi i sigurimit dhe ata shpjegojnë shqetësimet, mosmarrëveshjen dhe

ndërmjetësuesi i ndihmon të arrijnë në një përfundim. Nëqoftëse nuk arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen atëherë çështja i shkon gjyqit. Nëse ndërmjetësuesi arrin ta zgjidhi mosmarrëveshjen, atëherë palët e interesuara largohen me çështjen e zgjidhur dhe në kohë më të shkurtër.

Në mënyrë që një autoritet të sigurojë mbrojtje të përshtatshme për konsumatorin duhet që ai vetë të jetë i pavarur nga ana financiare dhe operative dhe kështu konsumatori të jetë në qendër të vëmendjes. Pavarësia financiare e ndihmon Autoritetin të ketë burimet e mjaftueshme që i nevojiten për të mbrojtur konsumatorin, të ketë stafin e duhur, të aftë e të mirëtrajnuar dhe të gjitha këto janë vendimtare. Do të ishte e vështirë të mbrohet konsumatori pa pasur numrin e duhur të punonjësve, pa njerëz të trajnuar.

Nga ana tjetër, pavarësia operacionale është gjithashtu e rëndësishme. Autoriteti është në pozicionin më të mirë për të vendosur se si të mbrojë konsumatorin në fushën e sigurimeve, të vendosë se cili duhet të jetë qëllimi i mbrojtjes së konsumatorit. Suksesi i Autoritetit varet nga pavarësia operative dhe përpjekja për të influencuar dhe për të vendosur se cila çështje duhet të rregullohet dhe cila jo.

ZHVILLIME TË TJERA

Inspektim i përbashkët i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Rrugore për policat e sigurimit të detyrueshëm të automjeteve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me Ministrinë e Brendshme realizoi, në datat 25-27 prill 2012, një inspektim të përbashkët me punonjësit e Policisë

Rrugore të Durrësit, Elbasanit dhe Lezhës.

Qëllimi i këtij inspektimi ishte zbatimi i dispozitave të Ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, në lidhje me:

Nga inspektimet rezultoi se 0.65% e mjeteve të kontrolluara nuk ishin të pajisura me policë sigurimi të detyrueshëm DMTPL.

- Evidentimin dhe verifikimin e mjeteve motorike pa polica të sigurimit të detyrueshëm motorik;
- Evidentimin dhe verifikimin e mjeteve motorike me polica të parregullta të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe të paraportuara në kohë reale në AMF në regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Inspektimi u krye në pikat hyrëse e dalëse të qyteteve, pika të cilat ishin përcaktuar më parë, aty ku edhe fluksi i qarkullimit të mjeteve motorike është më i madh. Gjatë tri ditëve të inspektimit u kontrolluan 308 mjete motorike nga të cilat 33 mjete me targa të huaja.

Inspektimet konstatuan disa mangësi në lidhjen me pajisjen e mjeteve me polica sigurimi të detyrueshëm, ndonëse këto u vërejtën tek një numër i kufizuar mjetesh. Nga inspektimet rezultoi se 0.65% e mjeteve të kontrolluara nuk ishin të pajisura me policë sigurimi të detyrueshëm DMTPL. Ndërkohë kishte disa parregullsi në raportimin e të dhënave të detyrueshme sipas bazës ligjore në fuqi nga shoqëritë e sigurimit në “Regjistrin Online të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike” të Autoritetit. Këto lidheshin me mospërputhjen e targës së shënuar në policën e sigurimit me atë mjetit për shkak të zëvendësimit të targave të vjetra me të reja, apo të lëshimit të policës për mjetin e siguruar

përpara se ai të targohej.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe për të kontribuar në rritjen e sigurisë rrugore kombëtare, do të vazhdojë bashkëpunimin me Drejtorinë e Policisë Rrugore. Aktualisht Policia Rrugore mund të kontrollojë në kohë reale policat e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike. Në qendrat operative të Policisë Rrugore është bërë e mundur hyrja në “Regjistrin Online të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike” të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (www.amf.gov.al). Për realizimin me sukses të këtij projekti, Policia Rrugore u ndihmua teknikisht nga Programi i Departamentit të Drejtësisë i Ambasadës Amerikane në Tiranë (ICITAP). AMF vlerëson gatishmërinë e bashkëpunimit e deritanishëm me Policinë Rrugore dhe dëshiron të forcojë edhe në të ardhmen të tilla bashkëpunime.

AMF po punon për të mos lejuar mangësi në drejtim të pajisjes me polica sigurimi të detyrueshëm të automjeteve, si edhe do të vazhdojë të monitorojë shoqëritë e sigurimeve në drejtim të raportimit të saktë të policave shitura prej tyre në sistemin online të shitjeve. Ky monitorim i vazhdueshëm që AMF realizon, është në funksion të rolit të saj në mbrojtje të konsumatorit dhe forcimit të tregut të sigurimeve.

Mbledhja e përbashkët e grupeve të punës së IOPS-it dhe OECD-së mbi Pensionet Private

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) në bashkëpunim me Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) zhvilluan në datat 4-6 qershor 2012 në Paris, Francë, mbledhjet e Komitetit Teknik dhe Ekzekutiv të IOPS-it, si dhe mbledhjen e përbashkët të grupit të punës IOPS&OECD mbi

Pensionet Private, WPPP.

Në mbledhjen e WPPP u diskutuan çështjet që lidhen me principet bazë të pensioneve, tregjet e kapitalit dhe instrumentat për transferimin e riskut të jetëgjatësisë. Në mbledhje u dhanë eksperiencia mjaft të rëndësishme mbi sistemin e fondeve të pensioneve në

autoritete homologe si Rusi e Sloveni. Me rëndësi ishin projekti mbi riskun e jetëgjatësisë dhe projekti mbi investimet afatgjata.

Në panelin *Projekti mbi riskun e jetëgjatësisë* për një menaxhim sa më të mirë të tij, diskutimet kishin të bënin me dy çështjet e rëndësishme: disa zgjidhje të tregut të kapitalit për riskun e jetëgjatësisë dhe instrumentat financiare për menaxhimin e riskut të jetëgjatësisë dhe instrumentat për transferimin e tij.

Në panelin e *Projektit mbi investimet afatgjate* u theksua se menaxhimi i riskut të jetëgjatësisë kërkon që fondet e pensioneve dhe ofruesit e pensionit vjetor të kenë për këtë qëllim mekanizma sa më të përshtatshme në dispozicion të tyre. Nga pjesëmarrësit u dhanë mendimet të vlefshme mbi këto mekanizma.

Çështje të tjera me rëndësi të diskutuara ishin edhe të tilla si: G20 mbi fondet e pensioneve dhe infrastrukturën e gjelbër; zbatimi i llogarive dhe rregullimeve ligjore në investimet afatgjata, si dhe fondet e pensioneve dhe infrastruktura në tregjet në zhvillim.

Në mbledhjet e radhës së Komiteteve të IOPS-it diskutimet u fokusuan ne problemet më të mprehta të mbikëqyrjes së sistemit të pensioneve. Në panelin e Komitetit Ekzekutiv diskutimet përfshinë:

- Përmbledhje nga sekretariati i IOPS-it të zhvillimeve të mbledhjes së fundit të Komitetit Ekzekutiv, si dhe zhvillimet e fundit në tregun e pensioneve;
- Projektet DC (skemat me kontributet e përcaktuara);

- Stress test i fondeve të pensioneve DC;
- Përditësimin e direktivave të Institucionit për Sigurimin e Daljes në Pension (IORP) nga përfaqësuesi i Komisionit Evropian;
- Informacionin nga anëtarët mbi zhvillimet më të fundit në autoritetet përkatëse.

Në Mbledhjen e Komitetit Teknik të IOPS-it tema kryesore ishte rigjenerimi nga kriza financiare globale që përfshiu edhe sistemin e pensioneve duke theksuar këtu rolin e madh të mbikëqyrësve të këtij tregu. Mbledhja e Komitetit Teknik solli në vëmendje të pjesëmarrësve një përmbledhje të problematikave të diskutuara në mbledhjen e fundit. Në mbledhje u diskutuan gjithashtu çështje administrative të organizatës. Në vazhdim diskutimet u përqendruan mbi projektet në vazhdim të organizatës:

- Draft udhëzuesi mbi qeverisjen e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve;
- Diskutim mbi përdorimin e principeve të IOPS&OECD dhe FSAP mbajtur nga përfaqësuesi i BB;
- Prezantim mbi strukturën e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve mbajtur nga sekretariati i IOPS-it;
- Mbikëqyrja e ndërmjetësve të pensioneve, si dhe;
- Nga OECD u mbajt në prezantim mbi punën e G20 dhe mbrojtjen konsumatore.

Mbledhja e ardhshme vjetore e IOPS-it do të zhvillohet në Kili më 22-24 tetor 2012.

Në Mbledhjen e Komitetit Teknik të IOPS-it tema kryesore ishte rigjenerimi nga kriza financiare globale që përfshiu edhe sistemin e pensioneve duke theksuar këtu rolin e madh të mbikëqyrësve të këtij tregu.

Licencohet shoqëria “ANSIG” sh.a. për ushtrim veprimtarie në tregun e sigurimeve

Në mbledhjen e datës 22 qershor 2012, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare miratoi dhënien e licencës, shoqërisë “ANSIG” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë në tregun e sigurimeve, për klasat e Jo-Jetës në përputhje me Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004.

Licencimi i shoqërisë “ANSIG” sh.a. vjen pas një shqyrtimi të kujdesshëm të dokumentacionit dhe hapave të ndërmarra nga shoqëria, në përputhje me kërkesat e dispozitave ligjore në fuqi. Licencimi i shoqërisë “ANSIG” kaloi në dy faza: në nëntor të 2011 Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare miratoi licencimin paraprak të kësaj shoqërie, e cila lidhej më përmbushjen e kërkesave të nevojshme për konturimin e biznesit të sigurimeve.

Në fazën e dytë, shoqëria përmbushi detyrimet lidhur me krijimin dhe regjistrimin e shoqërisë, përzgjedhjen e stafit drejtues, derdhjen e shumës së kapitalit fillestar dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për fillimin e aktivitetit. AMF i ka vlerësuar me kujdes të gjithë këta elementë, duke i kushtuar kujdes të veçantë edhe profesionalizmit të stafit.

Futja e një operatori të ri në tregun e sigurimeve është një sinjal tepër pozitiv. Ky sinjal duhet të interpretohet në disa drejtime. Së pari konfirmon zhvillimin e vazhdueshëm të tregut dhe faktin që tregu i sigurimeve është tërheqës për investitorë të rinj. Tregut të sigurimeve i injektohen menjëherë edhe 370 milionë lekë kapitale, që do të thotë kapacitet shtesë për nënshkrimin e risqeve në tregun vendas. Së dyti, efektet pozitive shtrihen dhe në aspektin makro për ekonominë në përgjithësi, duke realizuar hapjen e vendeve të reja të punës, pasi shoqëria e re do ketë prezencë në disa qytete kryesore të vendit. Së treti, futja e operatorit të ri do të rrisë më tepër presionin ndaj tregut për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorit. Konkurrenca cilësore është gjithnjë në interes të konsumatorit, por jo vetëm kaq, për AMF-në, një treg konkurrent me një numër në rritje të operatorëve, do të thotë më tepër hapësirë dhe fleksibilitet për ushtrimin e mekanizmave mbikëqyrëse dhe kjo përkthehet direkt në favor të mbrojtjes së konsumatorit.

Dinamika e zhvillimeve të tregut të sigurimeve, si segment i tregut financiar, e ka bërë këtë treg të jetë vazhdimisht në fokusin e investitorëve strategjikë.

Licencimi i shoqërisë “ANSIG” sh.a. vjen pas një shqyrtimi të kujdesshëm të dokumentacionit dhe hapave të ndërmarra nga shoqëria, në përputhje me kërkesat e dispozitave ligjore në fuqi.

Takime të Kryetares së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me Shoqatën e Sigurimeve të Austrisë dhe shoqëritë austriake që veprojnë në tregun e sigurimeve në Shqipëri

Me ftesë të Shoqatës së Sigurimeve të Austrisë, (VVO), në datën 28 qershor 2012, znj. Enkelelda Shehi, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe znj. Violanda Theodhori, Drejtore e

Departamentit Juridik, zhvilluan disa takime pune në Vjenë me këtë shoqatë dhe me shoqëritë e sigurimit Uniq Group Austria dhe Vienna Insurance Group (VIG). Synimi këtyre takimeve ishte forcimi i bashkëpunimit dhe

Të dy këto shoqëri austriake sigurimesh janë të pranishme në tregun shqiptar të sigurimeve prej vitit 2007 duke zotëruar aktualisht 36.62% të aksioneve në shoqëritë shqiptare të sigurimeve dhe duke zënë 64.45.% të volumit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto

koordinimi i përbashkët i përpjekjeve për një treg sigurimesh të suksesshëm.

Gjatë takimeve Kryetarja e AMF-së, Znj. Shehi, prezantoi treguesit kryesorë të zhvillimit të tregut të sigurimeve në Shqipëri, zhvillimet e reja, veçanërisht në fushën legjislative, si edhe tendencat e rritjes së këtij tregu. Që prej nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis AMF-së dhe Autoritetit të Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA), në korrik të 2009, është shtuar bashkëpunimi dhe shkëmbimi i eksperiencave midis dy vendeve. Në takimet me Drejtorin e Përgjithshëm të Shoqatës së Sigurimeve të Austrisë, Dr. Louis Norman-Audenhove u diskutua për mundësitë e forcimit të bashkëpunimit institucional midis dy organizmave si dhe mundësia e mbështetjes nga kjo shoqatë me eksperiencë shumëvjeçare për Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë dhe Byronë Shqiptare të Sigurimit.

Takime të veçanta pune u zhvilluan edhe me përfaqësues të menaxhimit të lartë të Uniqa Group Austria dhe Vienna Insurance Group (VIG). Të dy këto shoqëri austriake sigurimesh janë të pranishme në tregun shqiptar të sigurimeve prej vitit 2007 duke zotëruar aktualisht 36.62% të aksioneve në shoqëritë shqiptare të sigurimeve dhe duke zënë 64.45.% të volumit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto¹.

Gjatë takimit në UNIQA Group, Dr. Wolfgang Kindl, Drejtues Ekzekutiv i UNIQA International, dhe anëtar i Bordit të Drejtorëve UNIQA Group, si

dhe drejtues të lartë të kësaj shoqërie, bënë një panoramë të zhvillimeve të fundit të kësaj shoqërie në rajon dhe më gjerë, të objektivave afatmesme si dhe tendencat në zhvillimin dhe fuqizimit e biznesit në të dy vendet. Më pas delegacioni i AMF-së parashtrroi problematikat dhe nevojën e forcimit të bashkëpunimit në drejtim të rritjes së standardeve, përmirësimit të legjislacionit, sjelljes më të mire dhe aplikimit të eksperiencës austriake në drejtim të zgjerimit të gamës së produkteve dhe rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorit.

Gjithashtu, edhe në takimin e zhvilluar në ambientet e Vienna Insurance Group (VIG), pas një ekspozimi të Z. Hans Raumauf, anëtar i Bordit Ekzekutiv të VIG Grup dhe drejtues të tjerë të lartë të kësaj shoqërie të aktivitetit, nga ana e AMF-së u theksua rëndësia e prezencës dhe rritjes së influencës së investitorëve si VIG në tregun Shqiptar të sigurimeve. Ndikimi i kësaj kompanie në përmirësimin e treguesve, sjelljes së eksperiencave dhe standardeve austriake janë të dukshme. Por krahas arritjeve nga kryetarja e AMF iu prezantuan disa problematika specifike për secilën nga shoqëritë shqiptare të sigurimeve në mazhorancë të VIG. Në këtë kuadër u forcuan më shumë urat e bashkëpunimit dhe rritja e transparencës.

Bashkëpunimet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me VVO janë një traditë e rëndësishme.

Ato janë në vazhdim edhe të takimeve të zhvilluara vitin e kaluar.

1) Shoqëritë shqiptare të sigurimeve tek të cilat ka pjesëmarrje të kapitalit austriak në zotërimin e aksioneve të tyre janë: Sigma Vienna Insurance Group sh.a., Sigal Uniqa Group Austria sh.a., Intersig Vienna Insurance Group sh.a. dhe Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a., Interlbanian sh.a.

Përfaqësues të tregjeve të kapitaleve të Evropës Juglindore fillojnë punën për zbatimin e Platformës rajonale të integritimit. – Mbështetje nga programi për stabilitet Financiar, USAID.

Programi për Stabilitet Financiar i USAID-it zhvilloi më 29 qershor 2012, në Zagreb, Kroaci takimin e radhës me përfaqësues nga Rregullatorët, Bursat dhe Depozitarët Qendrorë të vendeve të Ballkanit. Në këtë takim u përfaqësua edhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Takimi konsistonte në diskutimin e finalizimit të Planit të Zbatimit në lidhje me projektin e integritimit të bursave të rajonit dhe të krijimit të një burse rajonale të quajtur T-REX. Eksperti i projektit, Z.

Hannes Takacs, me përvojë të gjatë në tregun e kapitaleve, prezantoi modelin e bursës rajonale, ku është parashikuar integritimi i 8 bursave të rajonit, përfshirë edhe Bursën e Tiranës. Në takim u krijua edhe Komiteti Drejtues, i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin në detaj të Planit të Veprimeve. Gjithashtu, në takim u diskutua dhe roli i institucioneve financiare ndërkombëtare dhe donatorëve, në mbështetje të projektit të integritimit të tregjeve të kapitalit për vendet e Ballkanit.

Në këtë takim u përfaqësua edhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Takimi konsistonte në diskutimin e finalizimit të Planit të Zbatimit në lidhje me projektin e integritimit të bursave të rajonit dhe të krijimit të një burse rajonale të quajtur T-REX.

TË REJA NGA RAJONI

Kroaci: Primi shkruar bruto vazhdon të bjerë

<http://www.xprimm.com/>

Sipas të dhënave të Byrosë Kroate të Sigurimeve, shumica e primeve të shkruara në tregun e sigurimeve gjatë tremujorit të parë të vitit 2012, ishte 2.53 miliard në monedhën vendase Kuna, (338 milion Euro), ose 0.8% më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara të 27 siguruesve Kroatë ishin në 1.12 miliardë Kuna ose 5.34% më shumë se një vit më parë. Tkurrja e tregut të sigurimeve u përcaktua kryesisht nga

rënia në vlerë e primeve të shkruara të Jo-Jetës me 1.6% ose në 1.96 miliardë Kuna. Rënie ka patur në volumin e sigurimit Kasko. Shumica e vlerës së primeve të shkruara të kësaj klase të sigurimit u ul krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2011 me gati 75%.

Tregu i sigurimit të Jetës u zhvillua në drejtim të kundërt në fillim të këtij viti: Primi i shkruar bruto arriti në 573 milion Kuna ose 2% më shumë se gjatë të njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Tkurrja e tregut të sigurimeve u përcaktua kryesisht nga rënia në vlerë e primeve të shkruara të Jo-Jetës me 1.6% ose në 1.96 miliardë Kuna.

Greqi: Produktet e lidhura me investimet mbajnë tregun

<http://www.xprimm.com/>

Prodhimi i përgjithshëm i primeve të tregut të sigurimit grek për tremujorin e parë të vitit 2012 u reduktua me 5%. Sipas një studimi të Shoqatës Greke

të Kompanive të Sigurimit (HAIC) në shoqatat e Jetës të lidhur me investimet, prodhimi i primit në degën e sigurimit është rritur fort me 79%

Gjashtëdhjetë e dy kompani sigurimesh kanë marrë pjesë në studimin e HAIC që përfaqëson 96.2% të prodhimit të primeve (përfshirë të drejtat e kontratës) sipas të dhënave të plota të industrisë së sigurimeve për vitin 2011. Nga kompanitë e mësipërme, 22 vepronin në Sigurimin e Jetës (99.3% e tregut) ndërsa 51 në sigurimin e Jo-Jetës (93,9% të tregut).

Gjashtëdhjetë e dy kompani sigurimesh kanë marrë pjesë në studimin e HAIC që përfaqëson 96.2% të prodhimit të primeve (përfshirë të drejtat e kontratës) sipas të dhënave të plota të industrisë së sigurimeve për vitin 2011. Nga kompanitë e mësipërme, 22 vepronin në Sigurimin e Jetës (99.3% e tregut) ndërsa 51 në sigurimin e Jo-Jetës (93,9% të tregut).

Në tremujorin e parë të vitit 2012, krahasimi i prodhimit të primit me të njëjtën periudhë të vitit 2011, për 62 kompanitë e mësipërme të shoqërive ishte 1.20 miliardë Euro përkundër 1.26 miliard në vitin 2011, e cila përfaqëson një rënie prej 5%.

Segmenti i sigurimit të Jetës është rritur me 4.7% me një prodhim të përgjithshëm 559 milionë euro

kundrejt 534 milionë Euro në vitin 2011. Një rritje edhe më e madhe është vërejtur në shoqatën e Jetës që lidhet me sektorin e investimeve me 79%, me një prodhim të përgjithshëm për tremujorin e parë rreth 155 milionë Euro kundrejt 86 milionë në vitin 2011.

Sigurimet e Jo-Jetës gjatë tremujorit të parë të vitit 2012 reduktuan produktivitetin e primeve me 12% duke mbledhur 645.89 milionë Euro kundrejt 733.89 milionë Euro në vitin e kaluar.

Për segmentet më të rëndësishme të Jo-Jetës, ulja më e lartë në primet u vërejt në 3 degët e sektorit të sigurimeve të Jo-Jetës lidhur me në sigurimin kasko me 23% (73.6 milion Euro përkundrejt 95.6 milion Euro në vitin 2011). Zjarri dhe rreziqet shtesë shënuan një ulje 12.8%.

Azerbaxhan: Rritje spektakolare dhe një lider i ri

<http://www.xprimm.com/>

Në periudhën janar - mars 2012, tregu i sigurimeve i Azerbaxhanit u rrit sipas monedhës Evropiane me 78%. Nga të ardhurat totale, u fituan nga sigurimi i Jetës 9.1 milion Euro, ndërkohë që nga sigurimi i Jo-Jetës u arritën 68.7 milion Euro. Në të njëjtën kohë, Sigurimi Shtetëror i Shërbimit të Mbikëqyrjes (The State Insurance Supervision Service), nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Financave raportoi për tremujorin e parë 2012, se volumi total i pagesave është 15.9 milion Euro, për 28 kompanitë e sigurimit që kryejnë

aktivitetin në Azerbaxhan.

Sipas rezultateve të centralizuara të Autoritetit Mbikëqyrës, PASHA Sigorta është lideri i ri në tregun e sigurimeve në Azerbaxhan. Lideri i ri i tregut për tremujorin e parë të vitit 2012, nënshkruajti mbi 22 milion Euro prime bruto. Kjo kompani zë 28.3% të tregut. Treshja e parë që dominon tregun, plotësohet dhe nga kompanitë si AzSigorta (7.3 milion Euro) dhe ATESGAH Sigorta (6.9 milion Euro).

Lideri i ri i tregut për tremujorin e parë të vitit 2012, nënshkruajti mbi 22 milion Euro prime bruto. Kjo kompani zë 28.3% të tregut.

Mali Zi: Primet e shkruara bruto rriten me 14%

<http://www.xprimm.com/>

Duke u bazuar në të dhënat e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi, për 12 kompanitë e sigurimit që operojnë në treg, primet bruto në fund të marsit zënë vlerën në total 15.6 milion Euro, me një rritje prej 14.2% më shumë, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2011.

Shifrat e fundit të publikuara, tregojnë

se segmenti i sigurimit të Jo-Jetës është rritur me 15.8% me vlerë 13.7 milion Euro, ndërkohë që primet e shkruara bruto të sigurimit të Jetës u rritën me 4.6% me vlerë 1.9 milion Euro.

LOVCEN vazhdon të udhëheqë tregun lokal të sigurimeve (me 39%), e vazhduar nga DELTA GENERALI (rreth 20% të tregut) dhe SAVA Montenegro (15% të tregut).

Rusi: 2013, viti kur do të zbatohen sistemi TI dhe Bonus-Malus

<http://www.xprimm.com/>

Në Asamblenë e Përgjithshme të Bashkimit Rus të Siguruesve Motorik, ndryshimet në Rregullat e Aktivitetit Profesional miratuan: një person nuk mund të lidhë një kontratë MTPL pa patur informacionin e plotë në lidhje më kontratën e mëparshme, në mënyrë që të përfundojnë të dhënat e sistemit TI. Ky sistem i ri TI do të ndihmojë në prezantimin e sistemit Bonus-Malus, e cila synon shoferët e disiplinuar duke

i dhënë një bonus ose një malus, duke u bazuar në të dhënat historike të dëmeve.

Sipas përfaqësuesve të Bashkimit Rus të Siguruesve Motorik, deri më 1 nëntor 2012, sistemi i TI do të testohet nga të gjitha kompanitë e sigurimit. Sistemi do të zbatohet plotësisht në fillim të vitit tjetër.

Sipas përfaqësuesve të Bashkimit Rus të Siguruesve Motorik, deri më 1 nëntor 2012, sistemi i TI do të testohet nga të gjitha kompanitë e sigurimit.

Për këtë numër punuan:

R. Guri, D. Kalaja, Dh. Hazbiu, R. Eltari, E. Kokona

